



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor  
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

# PLANI I PUNËS 2025

[www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)





# Prokurori i Shtetit

Plani i punës për vitin 2025





## Përmbajtja:

---

|                                                                                                               |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....                                                                              | 3  |
| Mandati i Prokurorit të Shtetit .....                                                                         | 4  |
| Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit .....                                                                   | 5  |
| Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit: .....                                                         | 6  |
| Vlerat.....                                                                                                   | 8  |
| Objektivat e Planit të Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2025 .....                                    | 9  |
| Efikasiteti në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale .....                                                    | 10 |
| I. Rritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të rëndësisë së veçantë.....                            | 10 |
| II. Aplikimi i institutit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe procedura alternative                   |    |
| III. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar dhe rikthimit të asteve .....  | 11 |
| IV. Trajtimi i rasteve të kallëzimeve penale me persona të panjohur PPP.....                                  | 11 |
| V. Mbrojtja ligjore për viktimat e krimit .....                                                               | 11 |
| Llogaridhënia dhe performanca .....                                                                           | 12 |
| I. Mbikëqyrja e rregullt e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve .....                                     | 12 |
| II. Mbikëqyrja e vazhdueshme nga autoritetet kompetente për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Integritetit ..... | 12 |
| Transparenca dhe komunikimi me publikun .....                                                                 | 13 |
| I. Informimi i publikut për çështjet me interes .....                                                         | 13 |
| II. Qasja në dokumentet publike .....                                                                         | 13 |
| III. Avancimi i punës së sinjalizuesve në luftimin e dukurive negative brenda institucionit .....             | 13 |
| Bashkëpunimi me akterët e sundimit të ligjit .....                                                            | 14 |
| I. Bashkëpunimi i Prokurorit të Shtetit me Policinë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese .....                  | 14 |
| II. Bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë .....                                              | 14 |
| III. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile .....                                       | 14 |
| Zbatimi dhe mbikëqyrja e Planit të punës .....                                                                | 15 |

## Përmbledhje e përgjithshme

---

Plani vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2025 është hartuar me qëllim të ushtrimit të mandatit ligjor dhe në zbatim të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore dhe kushtetuese.

Plani i punës për vitin 2025 përmban pjesën hyrëse, në të cilën përshkruhet mandati, përgjegjësitë dhe struktura organizative dhe vlerat e Prokurorit të Shtetit.

Në këtë plan janë përcaktuar shtyllat dhe objektivat kryesore të Prokurorit të Shtetit për vitin 2025, me të cilat synohet avancimi dhe ngritja e efikasitetit në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, llogaridhënies, transparencës dhe bashkëpunimit me akterët e tjerë të sundimit të ligjit.

Plani i punës ka edhe Planin e veprimit, në të cilin janë konkretizuar në formë tabelare aktivitetet, treguesit, bartësit e aktiviteteve dhe afatet kohore për realizimin e objektivave dhe nënobjektivave.

Zbatimi i këtij plani mundëson përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësiwe kushtetuese dhe ligjore të Prokurorit të Shtetit.

## Mandati i Prokurorit të Shtetit

---

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale.

Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat, pa asnjë diskriminim, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe konventa ndërkombëtare.

Prokurori është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzë, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.

## Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit

---

Përgjegjësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit përfshijnë:

- ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kodin e etikës profesionale;
- ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, dhe të pandehurve;
- ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
- ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

## Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit:

---

Prokurori i Shtetit ka strukturën organizative si në vijim:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, si instanca më e lartë e Prokurorisë së Shtetit, me kompetenca në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përveç mbikëqyrjes dhe monitorimit të punës të prokurorëve të shtetit, ndërmerrë edhe veprime juridike për të mbrojtur ligjshmërinë në të gjitha çështjet penale, civile, administrative dhe ekonomike.

Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit funksionon edhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, e cila është zyrë e pavarur për ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale.

- Prokuroria e Apelit, e cila është shkallë e dytë dhe ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me autorizim ligjor për të vepruar dhe përfaqësuar lëndët në Gjykatën e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e cila vendos për mjetet e rregullta juridike. Po ashtu, kjo prokurori ka kompetencë për të vendosur për ankesat kundër vendimeve për hudhje të kallëzimeve penale dhe aktvendimeve për pushim të hetimeve. Për më tepër vendos edhe për konfliktin e kompetencave në mes të prokurorive dhe vendos si shkallë e dytë përkitazi me përjashtimin e prokurorëve, si dhe vendos për kundërshtimin në konfliktin për kompetencë në mes të Kryeprokurorit të PSRK-së dhe kryeprokurorëve të prokurorive themelore.
- Prokuroria e Apelit ka këto departamente:  
Departamenti e Përgjithshëm;  
Departamenti për të Mitur dhe  
Departamentin për Krime të Rënda.
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, si organ prokurorial i specializuar, e cila ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me kompetenca dhe përgjegjësi për të hetuar dhe ndjekur krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PRSK-së.

- Prokuroria Speciale ka këto departamente:  
 Departamenti për Hetimin e Krimeve të Luftës;  
 Departamenti për Hetimin e Krimit të Organizuar;  
 Departamenti për Hetimin e Terrorizmit dhe  
 Departamenti për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimit Financiar.
- Prokuroritë themelore mbulojnë territorin e shtatë (7) rajoneve të Kosovës dhe kanë kompetencë lëndore dhe territoriale për të zhvilluar hetime dhe ndjekje penale, për të ngritur aktakuza dhe për të përfaqësuar në gjykatat themelore si gjykata të shkallës së parë.
- Prokuroritë themelore kanë këto departamente:  
 Departamentin e Përgjithshëm;  
 Departamentin për të Mitur dhe  
 Departamentin për Krime të Rënda.

Në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prishtinës vepron Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda.

## Vlerat

---

Prokurori i Shtetit si institucion i pavarur karakterizohet nga vlerat si:

- Profesionalizmi, llogaridhënia, pavarësia në punë dhe transparenca;
- Integriteti dhe etika e lartë;
- Paanshmëria, përkushtimi dhe objektiviteti në trajtimin e rasteve penale, duke u bazuar në standardet më të larta vendore dhe ndërkombëtare;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në punë dhe përdorimi racional i resurseve dhe
- Promovimi i bashkëpunimit me akterët e tjerë të sundimit të ligjit.



## OBJEKTIVAT E PLANIT TË PUNËS SË PROKURORIT TË SHTETIT PËR VITIN 2025



**EFIKASITETI NË HETIMIN DHE NDJEKJEN E VEPRAVE PENALE**



**LLOGARIDHËNIA DHE PERFORMANCA**



**TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN**



**BASHKËPUNIMI ME AKTERËT E SUNDIMIT TË LIGJIT**





Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar për ngritjen e efikasitetit në hetimin e veprave penale dhe zbulimin e kryerësve të veprave penale, përmirësimin e procedurave hetimore, marrjen e vendimeve të drejta dhe efikase, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Prokurori i Shtetit do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar dhe rikthimit të aseteve.

Prokurori i Shtetit do ta bëjë zbatimin e kësaj objektivë të përgjithshme përmes objektivave specifike si më poshtë:

### Objektivat specifike:

#### I. Krijta e efikasitetit në luftimin e veprave penale të rëndësisë së veçantë të:

- Korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
- Krimit të organizuar dhe pastrimit të parave;
- Veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë;
- Krimeve të luftës;
- Veprave penale kundër dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve, si dhe veprave të tjera penale me prioritet, si: luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore, krimet kibernetike, fajdeja, narkotikët, armët, mbrojtja e ambientit, etj.

#### II. Aplikimi i institutit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe procedurave alternative me anë të:

- Angazhimit të prokurorëve të shtetit për të aplikuar institutin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
- Inkurajimit të prokurorëve dhe palëve në procedurë për të aplikuar procedurën alternative në zgjedhjen e rasteve penale dhe
- Pezullimit të përkohshëm të procedurës penale për veprat penal të lejuara sipas ligjit.



### III. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar dhe rikthimit të asteve me anë të:

- Mbikëqyrjes së vazhdueshme të rasteve me sekuestrim të përkohshëm;
- Ngritjes së numrit të ekspertizave për hetimin financiar në rastet kur është e nevojshme;
- Rritjes së efikasitetit në zbatimin e ligjit për kompetencat e zgjeruara dhe
- Angazhimit të Koordinatorit Nacional dhe koordinatorëve të prokurorive për sekuestrim dhe konfiskim;
- Bashkërendimin e veprimeve të Zyrës për Rikthimin e Aseteve me akterët e përfshirë në zyrë;
- Trajtimin e rasteve të proceduara në ZRA nga agjencitë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës dhe
- Sensibilizimin e sistemit të drejtësisë dhe agjencive ligjzbatuese lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Rikthimin e Aseteve.

### IV. Trajtimi i rasteve të kallëzimeve penale me persona të panjohur PPP me anë të:

- Indeksimit të të gjitha rasteve me kryes të panjohur që kanë arritur afatin e parashkrimit absolut dhe mbylljen e tyre;
- Numrin e kërkesave të prokurorëve të shtetit drejtuar Policisë së Kosovës për zbulimin e identitetit të kryesve të këtyre veprave penale dhe
- Raportimin e rregullt të kryeprokurorëve për ecurinë e trajtimit të këtyre rasteve.

### V. Mbrojtja ligjore për viktimat e krimit, me anë të:

- Strukturimit të ri të Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave;
- Mbikëqyrjen e vazhdueshme të punës së ZMNV-së dhe
- Bashkërendimin e punës së ZMNV-së me institucionet e tjera në interes të mbrojtjes dhe ndihmës profesionale për viktimat e krimit.



Parimi i llogaridhënies do të jetë një nga vlerat themelore që do ta përcaktojë punën e Prokurorit të Shtetit përgjatë vitit 2025. Synimi ynë është që të kemi një institucion i cili respekton standardet etike dhe funksionon me profesionalizëm dhe integritet të lartë në punën e përditshme. Mbajtja përgjegjëse dhe llogaridhënës e kryeprokurorëve dhe e prokurorëve për punën e tyre është një nga prioritetet e prokurorit të shtetit.

Prokurori i Shtetit do ta bëjë zbatimin e kësaj objektive të përgjithshme përmes objektivave specifike, si më poshtë:

### Objektivat specifike:

#### I. Mbikëqyrja e rregullt e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve me anë të:

- Zbatimit të udhëzimeve të detyrueshme, të nxjerra nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
- Monitorimin e performancës së prokurorëve gjatë paraqitjes në seanca gjyqësore nga ana e kryeprokurorëve;
- Monitorimit të vazhdueshëm të prokurorëve përgjegjës të ZKPSH-së në prokuroritë përkatëse;
- Mbikëqyrjes së vazhdueshme të trajtimit të rasteve penale me theks të veçantë të lëndët karakteristike - me prioritet;
- Angazhimit të kryeprokurorëve në mbikëqyrjen e afateve të hetimit të filluar nga prokurorët e rastit
- Monitorimit të performancës së prokurorëve me mandat fillestar nga ana e mentorëve.

#### II. Mbikëqyrja e vazhdueshme nga autoritetet kompetente për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Integritetit me anë të:

- Trajtimit në kohë dhe në mënyrë objektive të rasteve të paraqitura kundër kryeprokurorëve dhe prokurorëve;
- Marrjen e opinioneve të vazhdueshme nga Komisioni i Etikës së KPK-së për sjelljet që eventualisht bien në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe
- Informimin e kryeprokurorëve dhe prokurorëve për angazhimet që janë jashtë detyrës zyrtare.



Kritja e transparencës institucionale dhe komunikimi me publikun mbetet një nga objektivat e përhershme të Prokurorit të Shtetit, me qëllim që publiku i gjerë të jetë i informuar lidhur punën, veprimet dhe vendimet e Prokurorit të Shtetit në të gjitha fazat e procedurës penale. Avancimi i transparencës paraqet parakusht për forcimin e besimit të publikut në vendimmarrjen institucionale në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Prokurori i Shtetit do ta bëjë zbatimin e kësaj objektive të përgjithshme përmes objektivave specifike si më poshtë:

### Objektivat specifike:

#### I. Informimi i publikut për çështjet me interes me anë të:

- Publikimit të akteve të nxjerra nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive;
- Publikimit të njoftimeve, komunikatave, reagimeve;
- Publikimit të raporteve periodike dhe vjetore të punës;
- Publikimit të raportit 24-orësh të veprimeve;
- Publikimit të Planit të veprimit për zbatimin e Planit të punës për vitin 2025;
- Paraqitjen e kryeprokurorëve, prokurorëve dhe zyrtarëve për komunikim në konferenca dhe mjete të informimit.

#### II. Qasja në dokumentet publike me anë të:

- Trajtimin të kërkesave me kohë nga zyrtarët për qasje në dokumente publike;
- Avancimit të raportimit lidhur me kërkesat e trajtuara për qasje në dokumente publike dhe
- Kontrollit dhe kujdesit për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### III. Avancimi i punës së sinjalizuesve në luftimin e dukurive negative brenda institucionit me anë të:

- Raportimit me kohë pranë institucioneve përkatëse të rasteve të identifikuara nga sinjalizuesit;
- Ofrimit të kushteve dhe kapaciteteve profesionale për sinjalizuesit dhe
- Raportimeve të rregullta për numrin e rasteve të raportuara.



Prokurori i Shtetit synon të avancojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë, me qëllim të realizimit të mandatit ligjor. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahja nga partnerët ndërkombëtarë është shtyllë e rëndësishme në fuqizimin e punës profesionale dhe të pavarur.

Gjithashtu, Prokurori i Shtetit do të fuqizojë bashkëpunimin ndërkombëtar në aspektin e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare, përmes formave të shkëmbimit të ndërsjellë të informacioneve, kthimit të kërkesave, nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave.

Prokurori i Shtetit do ta bëjë zbatimin e kësaj objektive të përgjithshme përmes objektivave specifike si më poshtë:

### Objektivat specifike:

#### I. Bashkëpunimi i Prokurorit të Shtetit me Policinë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese me anë të:

- Komunikimit dhe koordinimit të ngushtë me Policinë e Kosovës në trajtimin e çështjeve operacionale dhe rasteve penale;
- Bashkërendimit me Policinë e Kosovës për trajtimin dhe procedimin e rasteve me persona të panjohur (PPP);
- Bashkëpunimit dhe koordinimit me Policinë e Kosovës gjatë informimit të publikut për rastet të caktuara penale;
- Bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese në fusha të ndryshme, si me: Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Administratën Tatimore të Kosovës, Doganën e Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, etj.

#### II. Bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë me anë të:

- Koordinimit për nxjerrjen e akteve ligjore për sistemin e drejtësisë;
- Koordinimit me Gjykatën Supreme të Kosovës për qëndrime të përbashkëta juridike;
- Koordinimit dhe bashkëpunimit në rastet penale në kuadër të ndihmës juridike ndërkombëtare, përfshirë edhe prokuroritë e vendeve të tjera.

#### III. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile me anë të:

- Bashkëpunimit të Prokurorit të Shtetit me partnerët ndërkombëtarë në funksion të forcimit të sundimit të rendit dhe ligjit;
- Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë;
- Pjesëmarrjes në tryezat profesionale, të organizuara nga Prokurori i Shtetit apo shoqëria civile dhe
- Organizimit të takimit të përbashkët me organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë punën e sistemit të drejtësisë.

## Zbatimi dhe mbikëqyrja e planit të punës

Plani i punës për vitin 2025 bazohet në mandatin ligjor dhe në vizionin e Kryeprokurorit të Shtetit për udhëheqjen e institucionit të Prokurorit të Shtetit. Realizimi i këtij plani do të bëhet përmes zbatimit të objektivave dhe nënobjektivave, të cilat janë të matshme dhe të arritshme dhe do të realizohen me aktivitete dhe masa konkrete sipas afateve të caktuara.

Plani parasheh vazhdimin edhe të disa aktiviteteve dhe masave, të cilat kanë filluar në vitet paraprake dhe zbatimi i tyre do të vazhdojë edhe këtë vit.

Monitorimi lidhur me zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2025 do të bazohen në dy periudha raportuese: janar-qershor dhe korrik-dhjetor 2025.

Lidhur me veprimet e ndërmarra nga njësitë përgjegjëse, të cilat dalin nga ky Plan i punës është hartuar edhe Plani i veprimit, i cili do të përcjellë zbatimin e objektivave, nënobjektivave dhe aktiviteteve të parapara.



## PLANI I VEPRIMIT I PLANIT TË PUNËS SË PROKURORIT TË SHTETIT 2025

I

Efikasiteti në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale

Objektivi specifik: Rritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të rëndësishme të veçantë

Nr.

Nënobjektivat

Përgjegjës

Aktiviteti

Afati kohor

Treguesi

1.1.1

Luftimi i korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Prokuroria Speciale (PSRK), prokuroritë themelore (PTH-të) (përfshirë Njësitin për Korrupsion dhe Krime Ekonomike në PTH Prishtinë)

Takimet e rregullta të ekipit për shënjestrimin e rasteve  
Angazhimi i prokurorëve për më shumë ekspertiza financiare  
Monitorimi dhe raportimi i rregullt nga Komisioni Mbikëqyrës për Rastet e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Numri i rasteve të reja të shënjestruara  
Numri i rasteve të trajtuara sipas raporteve periodike  
Raportimi në kolegji  
Numri i ekspertizave financiare  
Raportet e Komisioni Mbikëqyrës për Rastet e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

|              |                                          |             |                                                                                                                                                                                                               |                                                          |                                                                                                                                                                                                                                             |
|--------------|------------------------------------------|-------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|              |                                          |             | <p>Mbështetja e Njësitit për Korrupsion dhe Krime Ekonomike me resurse profesionale</p> <p>Diskutimi në kolegjiune për çështjen e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike</p>                           |                                                          |                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>1.1.2</b> | Krimi i organizuar dhe pastrimi i parave | PSRK<br>PTH | <p>Takimet e rregullta të ekipit për shënjestrimin e rasteve</p> <p>Ngritja e kapaciteteve në hetimin e këtyre rasteve penale</p> <p>Fuqizimi i bashkëpunimit të prokurorit të rastit dhe policëve hetues</p> | <p>Janar - Qershor 2025</p> <p>Korrik - Dhjetor 2025</p> | <p>Numri i rasteve të reja të shënjestruara</p> <p>Rastet e trajtuara sipas raporteve të prokurorive përgjegjëse</p> <p>Rastet e trajtuara nga ekipet e përbashkëta</p> <p>Numri i trajnimeve të ndjekura nga prokurorët për këto vepra</p> |



|              |                                                     |      |                                                                                                                                                                                                                            |                                                          |                    |                                                                         |
|--------------|-----------------------------------------------------|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|--------------------|-------------------------------------------------------------------------|
|              |                                                     |      | <p>Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligjore dhe agjencitë ndërkombëtare</p> <p>Mbajtja e trajnimeve për të avancuar aftësitë e prokurorëve në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave</p> |                                                          |                    |                                                                         |
| <b>1.1.3</b> | Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë | PSRK | <p>Koordinimi me institucionet ligjzbatuese gjatë veprimeve operacionale</p> <p>Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë</p>                                                                                                | <p>Janar – qershor 2025</p> <p>Korrik – dhjetor 2025</p> | Takimet e mbajtura | <p>Raportet për rastet e trajtuara nga ky kapitull i veprave penale</p> |
| <b>1.1.4</b> | Krimet e luftës                                     | PSRK |                                                                                                                                                                                                                            |                                                          |                    | Strategjia e re e hartuar për krimet e luftës                           |

|              |                                                                                                                                                               |     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                          |                                                                                                                                                 |
|--------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|              |                                                                                                                                                               |     | <p>krimet e luftës,<br/>bazuar në<br/>strategjinë<br/>paraprake</p> <p>Bashkërendimi i<br/>aktiviteteve me<br/>departamentin<br/>përkatës në<br/>Policinë e Kosovës<br/>përfshirë edhe<br/>regionet</p> <p>Komunikimi i<br/>vazhdueshëm me<br/>misionin e BE-së<br/>për sundimin e<br/>ligjit, EULEX, për<br/>rastet e krimeve të<br/>luftës</p> |                                                                          | <p>Raportet për rastet e<br/>trajtura</p> <p>Mbështetja profesionale<br/>nga EULEX në trajtimin<br/>e këtyre rasteve</p>                        |
| <b>1.1.5</b> | <p>Veprat penale kundër<br/>dhunës në baza gjinore,<br/>dhunës në familje dhe<br/>abuzimit të fëmijëve, si<br/>dhe veprat e tjera penale<br/>me prioritet</p> | PTH | <p>Takimet e<br/>përbashkëta me<br/>institucionet<br/>relevante për<br/>bashkërendimin e<br/>veprimeve në rastet<br/>e dhunës në familje</p> <p>Avancimi i<br/>përditësimit të</p>                                                                                                                                                               | <p>Janar -<br/>qershor<br/>2025</p> <p>Korrik -<br/>dhjetor<br/>2025</p> | <p>Takimet e mbajtura</p> <p>Përditësimi permanent i<br/>databazës</p> <p>Raportet nga<br/>koordinatorët për këto<br/>kategoritë të veprave</p> |

|       |                                                                                    |                                                                     |                                                                                                                                                                                  |                                                   |                                                                                       |
|-------|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.1.6 | Veprat penale të kryera nga kryesit e mitur me theks të veçantë siguria në shkolla | PTH-të, Policia e Kosovës, prokurorët e departamenteve për të mitur | Mbajtja e fushatave sensibilizuese në institucionet arsimore dhe edukative<br><br>Kontrolllet e herëpashershme si veprime operationale në koordinim Polici – Prokurori i Shtetit | Janar – qershor 2025<br><br>Korrik – dhjetor 2025 | Aktivitetet e realizuara Informimi i publikut për veprimet e përbashkëta operationale |
|-------|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|

Objektivi specifik: Aplikimi i institutit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë si dhe procedura ve alternative

| Nr.   | Nënbjektivat                                                                                                          | Përgjegjës  | Aktiviteti                                                                                                                                                                                                        | Afati kohor                                   | Treguesi                                                                                                                                                                                |
|-------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.2.1 | Angazhimi i prokurorëve të shtetit për të aplikuar institutin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë                  | PSRK<br>PTH | Ofrimi i mundësisë për palët në procedurë për aplikimin e këtij instituti                                                                                                                                         | Janar – qershor 2025<br>Korrik – Dhjetor 2025 | Numri i rasteve të zgjidhura me aplikimin e këtij instituti                                                                                                                             |
| 1.2.2 | Inkurajimi i prokurorëve dhe palëve në procedurë për të aplikuar procedurën alternative në zgjedhjen e rasteve penale | PSRK<br>PTH | Ngritja e përqindjes të rasteve të referuara në procedurën alternative<br>Fuqizimi i komunikimit dhe ndërmjetësuesve<br>Mbikëqyrja sistematike nga kryeprokurorët në zgjedhjen e rasteve në procedurë alternative | Janar – qershor 2025<br>Korrik – dhjetor 2025 | Raportet me rastet e referuara në procedurë alternative<br>Takimet e mbajtura me ndërmjetësues<br>Raportet periodike të kryeprokurorëve me rastet e proceduara në procedurë alternative |

|              |                                                                                      |             |                                                                                                                                                                                                                              |                                                   |                                                                                                                       |
|--------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.2.3</b> | Pezullimi i përkohshëm i procedurës penale për veprat penale të lejuara sipas ligjit | PSRK<br>PTH | Inkurajimi i prokurorëve që veprat e rëndësishme të vogël të zgjidhen përmes kësaj procedure<br><br>Obligimi i të pandehurve të këtyre veprave penale që të kontribuojnë financiarisht në buxhetin e organizatave humanitare | Janar - qershor 2025<br><br>Korrik - dhjetor 2025 | Numri i rasteve të zgjidhura me aplikimin e kësaj procedure<br><br>Raport mbi shumën e kompensimeve nga kjo procedure |
|--------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Objektivi specifik: Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfu ndimtar dhe rikthimit të asteve

| Nr.          | Nënobjektivat                                                                          | Përgjegjës                                                                            | Aktiviteti                                                                                                                                                                                                         | Afati kohor                                       | Treguesi                                                                                                                                |
|--------------|----------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
